PRIMARSCHULGEMEINDE
Eichenwies Kriessern Montlingen Oberriet

# lokal KONZEPTI I ARSIMIT SPECIAL



## Info Flyer për Prindër



## Çdo fëmijë ka të drejtë për një Arsimim , mbështetje dhe trajnim të përshtatshëm për aftësit e tij. Nëse është e nevojshme, fëmijët mund të mbështetën më tej me masa të ndryshme mbështetëse.

Fëmijët sfidohen dhe inkurajohen sipas talenteve dhe aftësive të tyre, duke e projektuar situatën në klasë në mënyr të tillë që të gjithë pjesëmarrësit të gjejnë kushte më të përshtatshme të mësimdhënies dhe të mësuarit. Nxitja e vetëbesimit dhe ndjenjës së vetëvlersimit kanë domëthënje të rëndësishme për të edukuar fëmijët dhe për ti rritur në mënyr të pavarur. Mund të jetë që për shkak të vështirsive në mësim, problemeve të sjelljës apo edhe një talenti të lartë që Fëmijët të bëjnë mësim shtesë në klasë.

## Si mbështetje shtesë për të mësuarit në klasë janë në dispozicion edhe masat shtesë edukative

Në kuadër të nxitjes së Shkollimit të Integruar (ISF) fëmijët me nevoja të nxitjes nuk do të jenë të ndarë, por do të shkojnë në një klasë të rregullt me nxitje shtesë të integrimit. Përkrahja nuk përfshin vetëm objektin shkollor por edhe strategjin e mësimit dhe zgjidhjes së problemeve, si dhe fushat e përceptimit, komunikimit,aftësive motorike, sjelljes sociale dhe ndërtimit të përsonalitetit.Përveq promovimit të synuar të fëmijëve në një kontekst familjar, edukumi për nevoja të veqanta fokusohet në këshillimin dhe udhëzimin për prindërit dhe mjedisin. Arsimi për nevoja të veqanta zakonisht fillon në moshë parashkollore dhe mund të vazhdoi deeri në fund të kopshtitë për fëmijë. Në raste të caktuara individuale, arsimi me nevoja te veqanta mund të merret përsëri në qerdhe.
*www.hpdiendst.ch*

Në Logopedi do të përkrahen fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore të cilët kan qrregullime në komunikim dhe të folur, qrregullime të fjalës-zërit dhe gélltitjës/apo rrjedhjës së gjuhës.Nxitja më së shumti bëhet vetëm me përsonin i cila ka nevojë.
*www.logopaedieoberrheintal.ch*

Terapia Psikomotorike (do të ofrohet nga SRK-Terapia në Altstätten) fokusohet në levizjen e njëriut si shprehje e mardhënjës në mes trupit, shpirtit dhe brendësis. Ai supozon se përvoja e lëvizjës së trupit është një parakusht thëlbësor për zhvillimin motorik, sensorial, emocional,njohës dhe social të fëmijës. Në terapin psikomotorike do të nxitët dhe përkrahët ky zhvillim.
*www.srk-therapie.com*

*Terapia Disleksia* orientohet në fëmijët të cilët kanë vështirësi posaqërishtë në bazat e gjuhës së shkruar dhe të folur,të cilët kan probleme në përpunimin e perceptimit, vështërsi të vëmendjes, aftësitë për tu koncentruar ose në shpejtësin e punës.

*Terapia Diskalulite* orientohet në fëmijët të cilët kanë probleme themelore për të kuptuar bazat e matematikës, të marrjës me seriozitët siq janë vështirësitë në aftësit e konzentrimit, vështirësit e abstraktcionitë apo në shpejtësin e punës.

*Nxitja e Talentit* është në radhën e parë brenda klasës së rregullt.Nga njëra anë kjo nxitje do të bëhet përmes arritjës me tema shtesë ose me forma të veqanta të mësimitë, nga ana tjetër, me përshpejtimin e ^shpejtësisë`` së të mësuarit të këtyre fëmijëve p.sh-duke i tejkaluar klasët.
Në raste të vëqanta fëmijët vizitojn një herë në javë mësimin shtesë, me 2-3 lekcione në vend të mësimit të rregullt, nevojat përsonale të fëmijëve do të jenë në qendër të vëmendjës.

Në mësimin DAZ, pra gjermanishtja si gjuhë e dytë,do të përkrahën fëmijët migrant për mësimin e njohurive kryesore të gjuhës gjermane. Qëllimi është, përpunimi i njohurive gjermane në të shkruar dh të folur, kështu që fëmija në përditshmëri mos të ketë vështirësi poashtu ti shmangë edhe vështirësit e mësimit në klasë.

## Megjithëatë ka edhe fëmijë për të cilët masat përforcuese janë të domosdoshme dhe kuptimplota.

3. Pra kjo është e mundur, që ti mësojmë këta fëmij në një klasë të vogël. Shkolla fillore EKMO udhëheqë vitin bazê në Oberriet, i cili është një vit kalimtar apo ``Vit i pjekurisë`` në mes të Kopshtit të fëmijëve (Kindergarten) dhe klasës së 1-rë. Pas vititë bazë, zakonishtë fëmijët kanë një bazë të mirë për të qenë të sukseshëm në klasën e parë. Mundësitë e vazhdueshme janë që fëmijët me nevoja të vëqanta të mbështën n5 sjelljen shoqërore nga klasa e 3-të ne klasën e vogël Rajonale në Altstätten.
Fëmijët me nëvoja të veqanta intensive dhe specifike do të mësojn në një Shkollë të veqantë, e *cila ofronë* shkollë speciale, Terapeutike dhe socio-edukative.
Shërbimi Psikologjik i Shkollës *(SPD)* ofron Diagnostifikim dhe këshillime psikologjike dhe logopedike. Paraqitja bëhet zakonishtë përmes Shkollës në marrëveshje me Prindërit.
*www.schulpsychologie-sg.ch*



«Djali imë kishte vështirësi me llogaritje dhe shpeshëhere ishte i frustruar.Rezultatet e tij ishin të pamjaftueshme edhe pse ai rregullisht kishte ushtruar,tani ai cdo javë ndjekë mësim plotësues në një grup të vogël.Mësimi i Matematikës i ofron atij më shumë kënaqësi dhe është më i relaksuar, madje edhe kur ka Provim.»

Nëse Mësuesi i klasës vëren ndonjë problem të fëmija i juaj, atëhere ai do t`iu kontaktoi ju. Dhe sëbashku do të bisedoni mbi masat *shtesë që* fëmija juaj mund të përkrahet përveç mësimit në klasë.Nëse është e nevojshme do të kërkohet edhe një masë e veqantë edukative. Përgjatë procesit nxitës, do të zhfillohen konsultime të rregullta mbi ecurin e zhvillimit dhe progresit, në të cilin mer pjesë edhe eksperti i lëndës për masat e edukimit të veqantë (FLP). Gjatë masave të edukative për fëmijën tuaj nuk keni asnjë pagesë shtesë.

## Oferta e zgjeruar

Ergoterapia është trajtim medizinal i përshkruar nga ana mjeksore, kryesisht i orientuar në nxitjen për të vepruar në mënyr të pavarur. Kjo terapi do të përshkruhet nga Mjeku dhe financohet nga sigurimi shëndetësor. *Ndihma për detyrat e shtëpisë i`u shërben nxënësve* të cilët kan vështirësi që në mënyr të pavarur të bëjnë detyrat e shtëpisë. Fëmijët kanë mundësi që nënmbikqyrje, rregullisht ti kryejn detyrat e shkollës. Ndihma për detyrat e shtëpisë numëron ofertën e zgjëruar, që prindëritë të paguajnë një tarifë prej 80.00 Fr për semestër. Paraqitja bëhët përmes Mësuesit të klasës.

Shkolla për punë sociale,shkurtimisht SSA, përfshinë një grup pëfitimesh të punës sociale në favor të shkollës.Të adresuarit e këtij shërbimi janë nxënëset dhe nxënësit si dhe mjedisi i tyre familjarë sikur që janë Klasa, Mësuesi apo edhe Shkolla. Cdo njëri mund ta kontaktoi SSA. *www.jugend-or.ch*